




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-7129/24 datë: 19.03.2024



Npi – 01/119 datë: 28.03.2023

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14.1, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/207 të datës 21.03.2024, në seancën e mbajtur më 28.03.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR MARRJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË NGASTRËS KADASTRALE  
Nr.2148-10 NGA KRYQI I KUQ I KOSOVËS – DEGA NË SHTIME**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, me shumicën e votave, miratoi Vendimin për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga Kryqi Kuq i Kosovës – Dega në Shtime, në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-10. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup>. Kualiteti i klasës – Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit të Komunës Shtime – Shfrytëzues Kryqi Kuq i Kosovës, Dega në Shtime.

**II**

A r s y e t i m: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/6/3867 të datës 25.11.2005 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm Kryqit të Kuq të Kosovës – Dega në Shtime, sipërfaqen e tokës prej 1000m<sup>2</sup> (10 ari) në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-10, në Zonën Kadastrale – Shtime, për nevoja të veta të objektit të administratës, por që nuk është ndërtuar deri më tani. Duke marrë për bazë Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit "Ndërtimi i Objektit të Komunës së Shtimes" Nr.02/354 të datës 27.10.2022, në vlerën totale të projektit 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja imediate për sigurimin e lokacionit për këtë destinim, meqenëse Komuna e Shtimes si subjekt publik nuk posedon paluajtshmëri e cila evidentohet në emër të Komunës e që i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës të Komunës së Shtimes, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

**III**

Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

**IV**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

**V**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit  
Adnan Ademi